

S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Tiron Tech” Sh.p.k.

Ne baze te ligjit 9901,date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise” dhe akteve te tjera ligjore si dhe ne perputhje me kerkesat e ligjit 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”,

Sot ne daten 17 Shkurt 2021 (Dymije e njezete e nje)

Z. Lin Yuhai,atesia Shiqin,lindur me 07.10.1985 ne Fujian, RP China dhe banues ne Via Magazzino Idraulico N.1, Zevio (VR) 37059,Itali,shtetas kinez,madhor,me zotesi te plote juridike per te vepruar,i pajisur me numer personal **LNIYHU85R07Z210W**,

Z. Mauro Alessandro Ferrarese,atesia Giuseppe,lindur me 25.10.1986 ne Bari,Itali dhe banues ne Via Le Franceco Agello Nr.166/D, Desenzano del Garda (BS) 25015,Itali,shtetas italian,madhor,me zotesi te plote juridike per te vepruar,i pajisur me numer personal **FRRMLS86R25A662Q**.

Z.Arbis Prendi,atesia Nikolin,lindur me 02.12.1992 ne Rreshen-Mirdite,Shqiperi dhe banues ne Tirane,Rruga:“Bulevardi Kashar”,shtetas shqiptar,madhor,me zotesi te plote juridike per te vepruar,i pajisur me dokument identifikimi,karte identiteti **033920324** dhe numer personal **J212020370**.

Neni 1 K R I J O N E

Shoqeri private me Pergjegjesi te Kufizuar, ne emer “**Tiron Tech**” SH.P.K
Emertimi i shoqerise do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

Neni 2

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar “**Tiron Tech**” SH.P.K,eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuar ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 si dhe akte te tjera ligjore.

Neni 3



Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private, ne baze te ekonomise se tregut te lire. Ajo fiton zotesine juridike per te vepruar si Person juridik, qe nga momenti i regjistrimit ne QKB dhe me pajisjen me lejen e ushtrimit nga organi kompetent.

Neni 4 **Selia e Shoqerise**

Selia qendrore e Shoqerise "Tiron Tech" Sh.p.k. do te jete ne Durres, me adrese: **Zona kadastrale Nr.8515, Numri i Pasurise 6/362-N4, Volumi 23, Faqe 241, Lagjja 14 Shkozet, Durres.**

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne Durres, por mund ta zgjeroje ate dhe ne te gjithë territorin e vendit ose te hape filiale jashte vendit.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj sipas vullnetit te Asamblese se Ortakeve.

Neni 5

Personat pergjegjes per administrimin e shoqerise mund te vendosin hapjen e degeve ose zyrave te perfaqesimit te shoqerise brenda dhe jashte vendit. Deget jane vende te ushtrimit te veprimtarise tregtare dhe kane te njejtin personalitet juridik me shoqerine.

Keto zyra perfaqesimi nuk kane si qellim krijimin e te ardhurave, por nxitjen e veprimtarise se shoqerise.

Dega vepron nen emrin e regjistruar te shoqerise tregtare si dhe nen emrin e saj.

Neni 6

Te gjitha shkresat, formularet dhe cdo dokument tjeter korrespondence nxjerre nga shoqeria, deget, apo zyrat e perfaqesimit, nepermjet perdorimit te letres ose mjeteve elektronike te cilat iu drejtohen paleve te treta, duhet te permbajne te dhenat e meposhtme:

- Numrin unik te identifikimit.
- Formen ligjore te shoqerise.
- Vendndodhjen e selise se regjistruar dhe te zyres qendrore te saj.
- Te dhena nese shoqeria eshte ne likuidim.
- Nese shoqeria ka faqe interneti keto te dhena duhet te pasqyrohen aty.

Neni 7

Shoqeria pergjigjet per vertetesine e te dhenave te deklaruar.

Nxjerrja e shkresave, formulareve dhe e c'do dokumenti tjeter korespondence ne kundershtrim me nenin 11, pika 1 e ligjit 9901, date 14.04.2008, perben kundravajtje administrative dhe denohet me gjobe deri 15.000 Leke. Kjo kundravajtje administrative konstatohet gjate kontrollit te organizuar nga organet tatimore, te cilat ekzekutojne kete sanksion.

Neni 8 **Kohe-zgjatja**



Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë “**Tiron Tech**” është me afat të pacaktuar duke nisur që nga data e regjistrimit të saj në QKB. Kjo periudhë mund të shkurtohet kur shoqëria priset para kohe.

Neni 9 **Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “**Tiron Tech**” Sh.p.k. është si vijon:

Fason, prodhim, transformim, trajtim, blerje e shitje me shumicë përfshirë import dhe eksport, dhe pakice, online dhe jo, përfshirë edhe shërbimin e qeradhenies dhe shërbime ndërmjetesimi të produkteve në vijim:

Hardware, software, periferike informatike, telefonia, elektroshtepiake, elektronike të konsumit, produkte dhe makineri elektronike të çdo lloji, produkte të levizshmerisë elektrike, aksesore për fushën elektromjekësore për mireqenien shëndetësore dhe mbrojtje individuale, perberës dhe aksesore të çdo lloji përfshirë ato për përdorim industrial, pajisje dhe instrumente sportive të çdo lloji, përfshirë elementet perberës perkates, produkte ushqimore të paketuara dhe pije të çdo lloji, produkte të sektorit kozmetik hily ushqimore farmaceutike estetike, veshje dhe aksesoret perkates të çdo lloji për përdorim profesional dhe personal, mjete, makineri dhe materiale industriale dhe artizanale të çdo sektori dhe lloji, mjete pa targe dhe me targe të përgjithshme, përfshirë automjetet, shërbim reklamimi dhe publiciteti të çdo lloji online dhe jo, aktivitet call center i brendshëm për shoqërinë dhe rishitje e të njëjtit shërbim ndaj të tretëve, shërbim kërkimi dhe analiza regjistrimi për studime të tregut për përdorim vetjak ose ndaj të tretëve, shërbim logjistike të magazinimit të të mirave për shoqëri kombëtare dhe ndërkombëtare, shërbim këshillimi tregtar, industrial, ligjor, informacion mbi biznesin dhe lloje të ndryshme, shërbime të formimit dhe rritjes personale dhe tregti në lidhje me lloje të ndryshme biznesi aty ku nuk kërkohet kualifikim i veçantë, mobilje dhe arredim për përdorim profesional dhe personal.

Blerja e kuotave në shoqëri kombëtare dhe të huaja me objekt të shoqërisë të ngjashëm me sa më sipër, kuota të rëndësishme dhe strategjike për zhvillimin e shoqërisë.

Neni 10 **Kapitali Fillestar**

Kapitali fillestar i shoqërisë është **10.000 (Dhjetemije)Euro**, i cili përfaqëson kontributin fillestar të 3 ortakëve të shoqërisë “**Tiron Tech**” Sh.p.k.



Kapitali themeltar i shoqerise,eshte i ndare ne 3 (tre) kuota,me % e kapitalit qe zoteron secili si me poshte:

Emer Mbiemer	Kuotat zoteron	qe	% e kapitalit qe zoteron	Kapitali ne Euro
Lin Yuhai	1 kuote		34 %	3.400 Euro
Mauro Alessandro Ferrarese	1 kuote		33%	3.300 Euro
Arbis Prendi	1 kuote		33%	3.300 Euro

Neni 11

a) Kapitali fillestar i shoqërisë mund të shtohet, me vendimin e ortakeve të shoqërisë. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortaket kane të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre, por ata kane të drejtë të heqin dorë nga kjo e drejtë.

b) Kapitali fillestar i shoqërisë mund të zvogelohet me vendimin e marrë nga ortaket e shoqërisë.

c) Kapitali është i transferueshem dhe i trashgueshem sipas nenit 73 te ligjit 9901, date 14.04.2008. Transferimi i kapitalit themeltar duhet te behet me shkrim e te regjistrohet ne QKR.Te tretet duhet te respektojne transferimet sapo t'iu behet e ditur atyre. Shitblerja e kuotave ne radhe te pare iu afrohet ortakeve, nese ata nuk e pranojne, iu shitet te treteve.

Neni 12

Pas perballimit te detyrimeve,taksave,tatimeve dhe shpenzimeve te ndryshme, ortakeve u mbetet fitimi neto.

Ortaket kene te drejte te ndajne pjesen e fitimit te deklaruar ne Pasqyrat Financiare te shoqerise ne raport me kuotat e zoteruara. Ortaket vendosin per shperndarjen ose investimin e dividendeve. Shoqeria mund t'iu shperndaje fitime ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividendit, aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj.

Ne kete rast Administratori i shoqerise duhet te leshoje nje certifikate te aftesise paguese. Administratori pergjigjet ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese dhe pergjigjet personalisht per kthimin e dividendeve te shperndare, te cilat duhet t'i ktheje me mirekuptim, ose nepermjet padise gjyqesore.

Neni 13

Organet Drejtuese te Shoqerise

Organet drejtuese te Shoqerise "**Tiron Tech**" Sh.p.k. jane:

1. Asamblea e Pergjithshme
2. Administrator i Pergjithshem do te jete **Z.Arbis Prendi**,atesia Nikolin,lindur me 02.12.1992 ne Rreshen-Mirdite dhe banues ne Tirane, Rruga:"Bulevardi Kashar",shtetas shqiptar,madhhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,i pajisur me dokument identifikimi,karte identiteti **Nr.033920324 dhe ID J212020370**,per nje periudhe **5 (Pese) vjecare**.



Neni 14

Asambleja e pergjithshme e shoqerise "Tiron Tech" Sh.p.k. perbehet nga ortaket e shoqerise.

Te drejttat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme jane:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ben ndryshime ne Statutin e Shoqerise.
- Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar.
- Vendos per shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve.
- Ben mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit, pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Shfuqizon vendimet e padrejta te administratoreve dhe cakton demshperblimin e demit te shkaktuar nga ata.
- Rregullon marredheniet e punesimit dhe te shperblimit.
- Vendos per hapjen e aktiviteve te tjera ekonomike dhe filiale brenda dhe jashte Shqiperise.
- Vendos per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Investime.
- Miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.

Neni 15

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme mblidhet sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise dhe per te gjitha te drejttat dhe detyrimet qe ka Asambleja sipas nenit 15-te te statutit, jo me pak se nje here ne vit.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratori ose ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave te Asamblese se pergjithshme te shoqerise.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose mesazh elektronik ku te permbaje: vendin dhe rendin e dite. Njoftimi duhet te jete te pakten 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese, ne te kundert mbledhja e Asamblese quhet e pavlefshme.

Neni 16

Perfaqesimi ne Asamble

Ortaku mund te perfaqesohet ne Asamblene e pergjithshme ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete, por administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne Asamblene e pergjithshme.



Neni 17
Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne shumice te zakonshme, Asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 50% te kuotave.

Neni 18
Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e votave te ortakeve pjesmarres qe zoterojne kapital sipas nenit 17-te te statutit. Per ceshtje si: ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, pranimi ose largimi i ortakut, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe perishjen e shoqerise, vendimet jane te vlefshme kur marrin pjese 80% te votave te ortakeve pjesmarres.

Neni 19
E drejta e votes dhe perjashtimi nga e drejta e votes

C' do kuote jep te drejten e nje vote e cila ushtrohet nga ortaket ne Asamblese e pergjithshme per marrjen e vendimeve.

Mundesine e pjesmarrjes ne mbledhjen e Asamblese se pergjithshme te ortakut behet me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire edhe ate elektronike.

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese ne Asamblese e pergjithshme merr vendim per vleresimin e veprimtarise se tij te ndonje detyrimi ne ngarkim te tij ose ngritjen e nje padie ndaj tij nga Shoqeria.

Ortaku qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise ka te drejte t'i kerkoje Gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit ose shperblimin e demit te shkaktuar si mpasoje e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga casti i cenimit.

Neni 20

Te gjitha vendimet e Asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne proces-verbal, ku i bashkalidhet eshte lista e pjesmarresve si edhe akti i thirrjes se Asamblese se Pergjithshme.

Administratori pergjigjet per ruajtjen e proces-verbaleve dhe jo me vone se 15 dite nga data e mbledhjes, jane te detyruar te publikojne kopje te ketij proces-verbali ne faqen zyrtare te internetit te shoqerise.

Neni 21
Hetimet e posacme

Asambleja e pergjithshme mund te vendose nisjen e nje hetimi te posacem per parregullsite ne themelimin e shoqerise ose te ushtrimit te veprimtarise tregtare.

Hetimi kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes.

Ortakët që përfaqësojnë 5% të totalit të votave në Asamblenë e shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblësë së përgjithshme emerimin e një eksperti të pavarur të fushës kur ka dyshime për shkelje të ligjit ose të statutit të shoqërisë.

Kur Asambleja e refuzon kërkesën, atë brenda 30 ditëve i drejtohen Gjykatës për emerimin e këtij eksperti.

E drejta e padisë ushtrohet brenda 3 vjetëve nga konstatimi i parregullsisë.

Neni 22 **Administratoret**

Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizik si administratorë të shoqërisë, emerimi i të cilëve nuk mund të jete më shumë se 5 vjet, me të drejtë perseritjeje.

Neni 23

Administratori i shoqërisë tregtare mëmë nuk mund të emerohet administrator i një shoqërie të kontrolluar ose anasjelltas.

Te drejtat dhe detyrimet e Administratorëve


- Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e përgjithshme
- Përfaqësojnë shoqërinë tregtare
- Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave, të librave kontabel, nënshkruajnë bilancin vjetor, raportin e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve dhe i paraqesin këto dokumenta përpara Asamblësë së përgjithshme për miratim
- Raportojnë para Asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare nga shoqëria për zbatimin e statutit dhe ligjeve në fuqi. Ata dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për QKR-në.
- Thërresin Asamblenë e përgjithshme sipas rregullave të percaktuara në ligj dhe kërkojnë një sistem paralajmërimi në kohën për rrethanat që kërcenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.

Neni 24

Administratori duhet të ushtrojë kompetencat që u njihen me ligj ose statut vetëm për arritjen e qëllimeve të percaktuara në nenet 97,98 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.

Neni 25

Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standartet profesionale janë të detyruar t'i demshperblejnë shoqërisë demet. Ata përgjigjen para shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që shkel statutin ose kryejnë verime të parregullta.



Administratoret janë të detyruar të demshperblejnë shoqerine sipas pikes 4 të nenit 98 të ligjit 9901, date 14.04.2008.

Neni 26

Shoqeria "Tiron Tech" Sh.p.k., ka vulen e vet me mbishkrimin "Tiron Tech" Sh.p.k.

Neni 27

Marredheniet Ekonomike-Financiare

Shoqeria "Tiron Tech" Sh.p.k., vepron në regjimin e pronës private. Ajo merr persiper të drejta dhe detyrime kontraktore dhe jashtë kontraktore brenda kapitalit të saj.

Neni 28

Shoqeria "Tiron Tech" Sh.p.k., mund të hapin numra llogarie në leke dhe valute në bankat shqiptare të nivelit të dytë dhe të huaja.

Shoqeria "Tiron Tech" Sh.p.k., ka të drejta të tjetërsimit, disponimit e të përdorimit të pasurive të veta në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 29

Llogatite vjetore

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqerisë "Tiron Tech" Sh.p.k., mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, përveç urdherave të veçanta që jep administratori i shoqerisë për këto qëllime.

Në fund të periudhës ushtrimore nxirren Pasqyrat Financiare të shoqerisë me rezultate ekonomike të fitimit dhe humbjes sipas ligjeve financiare. Pasqyrat Financiare miratohen nga Asambleja e përgjithshme, firmoset nga administratori i shoqerisë dhe kopje e tyre depozitohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore përkatëse dhe në QKB.

Miratimi i dokumentave mbi veprimat vjetore bëhet brenda një afati prej 6-muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 30

Ekspertet Kontabel të Autorizuar

- Në rast nevojë si edhe kur kërkohet me ligj, kontrolli i shoqerisë kryhet nga eksperti kontabel i autorizuar, i emëruar për 2 vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga ortaket.
- Shkarkimi i ekspertit kontabel të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si edhe emërimi i tij, në rast se verëhen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

Neni 31



Per ruajtjen dhe sigurimin e pasurive te saj te luajteshme dhe te paluajteshme, kjo shoqeri mund t'i drejtohet shoqerive te sigurimit.

Neni 32 **Marredheniet e punes**

Ne kete shoqeri mund te punesohen persona fizik vendas dhe te huaj te profesioneve dhe specialiteve te ndryshme, sipas nevojave te shoqerise.

Marredheniet e punes rregullohen sipas kodit te punes se Republikes se Shqiperise dhe ligjeve te tjera ne fuqi.

Nenpunesat,punetoret she spacialistet qe do te merren ne pune nga shoqeria "Tiron Tech" Sh.p.k., do te merren ne baze te kontrates se punes te miratuar nga te dy palet.

Cdo person i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te ruaje sekretin e shifrave te karakterit te fshehte te dokumentacionit, te permbushte detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes si dhe vendimet e marra nga shoqeria.

Neni 33 **Asambleja dhe Keshilli i punemarresve**

Ne rastet kur shoqeria do te punesoje me shume se 50 punemarres krijohet:

1. Asambleja e punemarresve, e cila perbehet nga te gjithë punemarresit e shoqerise.
2. Keshilli i punemarresve, i cili zgjidhet nga Asambleja e punemarresve me vote te fshehte. Per cdo 10 punemarres, zgjidhet nje anetar keshilli me mandat maksimal deri ne 5 vjet.

Neni 34

Keshilli i punemarresve monitoron zbatimin e ligjeve, te kontratave kolektive dhe dispozitave te statutit dhe perfaqeson interesat e punemarresve te shoqerise. Ai raporton para Asamblese se punemarresve te pakten 2 here ne vit.

Perfaqesuesi ligjor i shoqerise mban keshillin e punemarresve te informuar per veprimtarite dhe ecurine e shoqerise, per kushtet e punes,pagat,sigurine ne pune, ndarjen e mundshme te fitimeve,ndryshimin e statutit, sistemin e pensioneve te shoqerise dhe per raportet e keshillit mbikqyres.

Neni 35 **Prishja e Shoqerise dhe Likuidimi**

Prishja e shoqerise mund te behet per shkaqet e parashikuara nga neni 99 e ligjit 9901 date 14.04.2008.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos per menyren e likuidimit dhe cakton likuidatorin,i cili paraqet raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshme te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likuidimit ortaket vendosin mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuiduesit dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit.



Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura tek ortakët proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar.

Neni 36 **Shnderrimi i shoqerise**

Shnderrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri kolektive ose shoqeri komandite si dhe ne shoqeri anonime mund te kryhet vetem me miratimin e ortakëve.

Neni 37

Per ruajtjen e sigurimin e pasurive te saj te luajteshme dhe te paluajteshme, kjo shoqeri mund t'i drejtohet shoqerive te sigurimit ne qender dhe ne deget e saj.

Neni 38

Mosmarveshjet e Shoqerise ne marredheniet me personat fizik e juridik, vendas apo te huaj, zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert nese kjo nuk arrihet, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres.

Neni 39

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ne republiken e Shqiperise", si edhe te ligjeve te tjera te shpallura per kete qellim.

Neni 40

Statuti i shoqerise "**Tiron Tech**" Sh.p.k., perpilohet ne 3(tre) kopje origjinale per t'iu dorezuar organeve kompetente, nga te cilat nje kopje depozitohet ne QKB dhe nje kopje i mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te formimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "**Tiron Tech**" Sh.p.k


Ky statut u miratua sot me date 17 Shkurt 2021 (Dymije e njezete e nje)

ORTAKET E SHOQERISE

Lin Yuhai

Mauro Alessandro Ferrarese

Arbis Prendi

Lin Yuhai


MAURO ALESSANDRO FERRARESE


ARBIS PRENDI
